

VENDIM
Nr. 248, datë 9.5.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 440, DATË 16.6.2005, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI AKADEMISË
SË SHKENCAVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7 e 8, pika 3, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 440, datë 16.5.2005, të Këshillit të Ministrave, nga prona me emërtimin “Akademia e Shkencave, Tiranë”, me numër rendor 8, të hiqet komponenti përbërës me emërtimin “Fondi i librave, magazinë”, me sipërfaqe të përgjithshme 297 (dyqind e nëntëdhjetë e shtatë) m², sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Akademia e Shkencave dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te veçanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror : **Akademia e Shkencave**

Bashkia : **Tirane**

Supervizoi: **Florian Progri (Specialist)**

(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Fusha e perdorimit te Prones : **Administrative**

Aprovoi:

Fadil Kepi (Shef i Sekt. te Pergj. te Ak. Shkencave)

(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

A			B				C			
Nr. Rend	Zona Kadestr. Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Emertesa e Prones Vend ndodhja / Shtrirja Gjeografike	Komponentet perberes te Prones	Adresa/Vend ndodhja e komponenteve perberes	Permasat e Prones ne m ² ose mi	Funkcioni per te cilin pardoret Prona	Institucioni/Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
8			Akademia e Shkencave Tirane		Sheshi "Fan Noli"	1128.25		Akademia e Shkencave	Akademia e Shkencave	
				Salla e mbledhje		180	Administrative	Akademia e Shkencave	Akademia e Shkencave	
				Zyre dhe garazhe		299.25	Administrative Ambjente ndihmese	Akademia e Shkencave	Akademia e Shkencave	
				Godina e re Enciklopedia		352	Administrative	Akademia e Shkencave	Akademia e Shkencave	Ndertese dy kate
				Fondi i librave magazine		297	Ambjente ndihmese	Akademia e Shkencave	Akademia e Shkencave	

